



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:099321

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05654748

**P. nr.80/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me Nd.nr.8/2024, të datës 21.02.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.635/2022, të datës 17.05.2022 kundër të akuzuarit A.(S.) N. nga fshati Z., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.6 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, dhe nenit 2 par. 2, 8, 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), **më 03 maj 2024, nxjerri këtë:**

#### **A K T V E N D I M**

**I. MIRATOHET** marrëveshja me numër Nd.nr.8/2024, të datës 21.02.2024 e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Malishevë, ndërmjet të akuzuarit A.(S.) N. nga fshati Z., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.6 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe të dëmtuarës KEDS Distrikti në Gjakovë, përfaqësuar nga Arjana Mula në anën tjetër.

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.635/2022, të datës 17.05.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarit A.(S.) N. nga fshati Z., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.6 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

**IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr.635/2022, të datës 17.05.2022, kundër të akuzuarit A.(S.) N. nga fshati Z., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314 par.6 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata më 21.02.2024, e ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë e duke vepruar në bazë të nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Institutin për Ndërmjetësim në Malishevë.

Më 21.02.2024, në Qendrën për Ndërmjetësim në Malishevë, është arritur marrëveshja Nd.nr.8/2024, në mes të palëve në procedurë. Andaj gjykata duke vepruar në bazë të dispozitës së nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovojë këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin më datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data **02 maj 2024**, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u morën në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2,15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL  
P.nr.80/2022, më 03 maj 2024**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Njazi MORINA**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

Numri i lëndës: 2022:099321  
Datë: 03.05.2024  
Numri i dokumentit: 05654748